



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:282389

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05693734

P.nr.334/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit F.I, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1195/2022 e datës 27.12.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **28.02.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit S.M dhe të pandehurit F.I se bashku me mbrojtësen e tij av. Venera Gashi-Selmanaj, e caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 28.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.I nga i ati R. dhe e ëma Sh. e gjinisë T., i lindur me datë ... në fshatin K., Komuna F., ku dhe jeton, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë të elektros, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal 1012827616, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, *aktualisht gjendet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës për një vepër tjetër penale.*

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datën 02.06.2022, rreth orës 10:30 minuta, në Burgun e Dubravës Komuna Istog, pikërisht në krahun J2 dhoma D1, me dashje e me send me të cilin mund të shkakton lëndim të rëndë trupor, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit S.M, në atë mënyrë që i pandehuri dhe i dëmtuari gjenden në vuajtje të dënimit dhe gjersa të njëjtit ishin duke qëndruar në dhomë, i pandehuri e merr një bakall me ujë të vluar dhe të njëjtin ia hedh të dëmtuarit në kokë, ku uji i bie në fytyrë dhe trup, e si pasojë e kësaj të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore.

- me çka ka kryer veprën penale **lëndimi i rendë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 79 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I. Ashtu që, të pandehurit F.I, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, *i cili dënim do te jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet*, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
 - **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II. I pandehuri lirohet në tersi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.
- III. **Pala e dëmtuar:** S.M nga Gj. rr. "Ali Ibra" nr.8, *i cili aktualisht gjendet në Qendren Korrektuese në Dubravë*, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1195/22 e datës 27.12.2022, kundër të akuzuarit F.I i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, i dëmtuari S.M dhe i pandehuri F.I se bashku me mbrojtësen e tij av. Venera Gashi-Selmanaj, e caktuar sipas detyrës zyrtare, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri F.I, pas konsultimit me mbrojtësen e tij, ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, i kërkon falje palës së dëmtuar i cili është prezent në seancë dhe i premtos gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit për veprën penale e cila i bije në barrë, pasi që konsideroj se është në kushte të përcaktuara sipas ligjit.

I dëmtuari S.M, lidhur me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit, pas ditës kritike nuk kanë pasur më probleme dhe i kanë rregulluar raportet.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Venera Gashi-Selmanaj lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi im, ky pranim fajësie është bërë pas konsultimeve të mjaftueshëm me mua si mbrojtëse, lidhur me pasojat dhe privilegjet e pranimin të fajësisë, dhe ky pranim gjënë mbështetje dhe në shkresat e lëndës, e një herët pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe i njëjti ndihet i penduar për veprimet e tij, prandaj e lusim gjykatën që ta pranoj pranimin e fajësisë për të mbrojturin tim dhe njeherit me rastin e shqiptimit të dënimit të këtë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të njëjtit t'i shqiptoj një dënim me të butë të paraparë me ligjin.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtë aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtë aktgjykimi.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes se kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është pendur për këto veprime, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar dhe i ka rregulluar raportet me palën e dëmtuar, si dhe moshën e tij; ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se ka qenë i dënuar edhe me parë nga gjykatat me aktgjykime të formës së prerë në çështjet penale te evidentuara ne sistemin SMIL me numrat: 2023:143982 dhe 2021:035281. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtui pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 te KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me te cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënim për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore te verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 4 të KPP-së, e liroj të pandehurin nga shpenzimet e procedurës për faktin se i njëjti, është ne vuajtje të dënimit dhe i pa punë, dhe se pagesa e këtyre shpenzimeve do të i'a rrezikonte gjendjen e tij materiale dhe të anëtareve te familjes te cilët detyrohet ti mbështes materialisht.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesave pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 457, 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*